



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.669/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Faton Bajrami, në çështjen juridike përmbare të kreditorit “BETA GROUP” SH.P.K., me seli në Lipjan, rr.“Sadik Shala” nr.146, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D.M., kundër debitorit “ETNA GROUP” SH.P.K., me seli në Prishtinë, rr.“Shefqet Shkupi” nr.9, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.O., avokat në Prizren, me bazë juridike përmbare për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarës së kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.690/2022 të datës 14.02.2023, me datë 01.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e autorizuarës së kreditorit “BETA GROUP” SH.P.K., me seli në Lipjan, rr.“Sadik Shala” nr.146, **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.690/2022 i datës 14.02.2023, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.690/2022 të datës 14.02.2023, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “ETNA GROUP” SH.P.K., ka anuluar urdhri përmbare P.nr.643/2021 të datës 07.05.2021, të përmbaresit privat Destan Bujupaj dhe ka përfunduar në tërësi përmbaremi në këtë çështje përmbare.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur e autorizuara e kreditorit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbare, me propozim që të aprovet ankesa në tërësi si e bazuar, aktvendimi i ankimuar të prishe dhe ndryshohet në dobi të kreditorit ashtu që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të vërtetohet në tërësi si i bazuar urdhri përmbaremi P.nr.449/21 i datës 02.06.2021.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur debitori.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e autorizuarës së kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “BETA GROUP” SH.P.K., me seli në Lipjan, rr.“Sadik Shala” nr.146, me datë 06.05.2021, ka paraqitur propozim për përmbarrim kundër debitorit “ETNA GROUP” SH.P.K., me seli në Prishtinë, rr.“Shefqet Shkupi” nr.9, në bazë të dokumenti të besueshëm, faturës nr. SIT-19/21 të datës 04.05.2021 dhe faturës nr.SIT-20/21 të datës 04.05.2021, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 32,133.90 €.

Përmbarruesi privat Destan Bujupaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit me urdhrin P.nr.643/2021 të datës 07.05.2021, ka lejuar përmbarrimin, duke vlerësuar se faturat e lëshuar nga kreditori i plotësojnë kushtet për përmbarrim. Kundër këtij urdhri përmbarrimor debitori me datë 30.06.2021 ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarrimor, me arsyetimin se detyrimi i përcaktuar dhe i lejuar me propozim nuk ekziston dhe se debitori asnjëherë nuk ka marrë materialin e përshkruar si në fatura, ndërsa në mes të palëve as që ka pasur ndonjë punë juridike të vlefshme në raportet në mes tyre. Tutje ka shtuar se faturat kanë një nënshkrim me të cilin figuron emri i pronarit të debitorit për të bërë faturën dokument të besueshëm në mënyrë fiktive dhe për të vënë në lajthim organin përmbarrues për të vazhduar një procedurë joligjore përmbarrimore duke shtuar se nënshkrimi i vendosur në faturat të cilat janë dokument i besueshëm janë të falsifikuara dhe nuk janë të nënshkruara nga ana e debitorit, dhe se fatura nuk është e vulosur me vulën e debitorit. Me propozim që të aprovohet si i bazuar prapësimi, të lihet jashtë fuqie urdhri përmbarrimor P.nr.643/2021 i datës 07.05.2021 dhe të refuzohet propozimi për përmbarrim i kreditorit si i pabazuar dhe joligjor. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditorit me datë 05.07.2021, duke i kundërshtuar të gjitha pretendimet e debitorit në prapësim, me arsyetimin se debitori ka pranuar shërbimin me furnizim me material shufër çeliku dhe për mallin e pranuar nga debitori është lëshuar fatura të cilat debitori i ka pranuar dhe i ka nënshkruar, duke shtuar se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim janë qartazi me qëllim të prolongimit të pagesës së borxhit që ka ndaj kreditorit, të pabazuara dhe për asnjërin pretendim nuk ka sjellë dëshmi me të cilat do të vërtetoheshin këto pretendimet siç parashihet me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së. Më tutje ka shtuar se faturat në bazë të së cilave është lejuar përmbarrimi janë në origjinal dhe i kanë të gjitha tiparet e përmbarrueshmërisë në kuptim të nenin 21, lidhur me nenin 29 paragrafi 1, pika 1.3 të LPP-së, duke propozuar që të refuzohet në tërësi prapësimi si i pabazuar, ndërsa urdhri përmbarrimor P.nr.643/2021 i datës 07.05.2021 të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimi dhe përgjigjes në prapësim me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.690/2022 të datës 14.02.2023, ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit “ETNA GROUP” SH.P.K., ka anuluar urdhri përmbarrimor P.nr.643/2021 të datës 07.05.2021, të përmbarruesit privat Destan Bujupaj dhe ka përfunduar në tërësi përmbarrimi në këtë çështje përmbarrimore., duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomik, ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, në mbështetje të dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së dhe nenit 12 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarrimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarrimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarrimore të përfundohe në tërësi, për arsyes se në rastin konkret fatura nr. SIT-19/21 e datës 04.05.2021 dhe fatura nr.SIT-20/21 e datës 04.05.2021, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarrim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbarrim janë të nënshkruara dhe të

vulosura vetëm nga ana e kreditorit, ndërsa të njëjtat nuk janë të vulosura dhe të nënshkuara edhe nga ana e debitorit dhe meqenëse nuk ka dëshmi se debitori i ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat, si të tilla të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përmbareshmërisë, përderisa njëra palë procedurale – debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Andaj, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në rastin konkret dokumentet e besueshme mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbareshmëri, e mbi bazën e të cilat përmbareshmëri privat ka lejuar përmbareshmërin, nuk kanë tipare të përmbareshmërisë, dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbareshmërisë duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë si dhe të gjitha shkresat e lëndës, kanë gjetur se një aktvendim i tillë është i pabazuar dhe nuk ka mbështetje ligjore dhe as mbështetje në shkresa e lëndës.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësojnë se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1, 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, e lidhur me nenin 29 paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.3 dhe nenin 71 të LPP-së, ku gjykata nuk ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore dhe kjo ka pasur ndikim në nxjerrjen e vendimit jo të ligjshëm.

Aktvendimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, pasi që dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm, në kundërshtim me arsyet e aktvendimit e po ashtu arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të mangëta dhe të paqarta.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë tani për tani nuk mund ta pranojë qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me atë se faturat në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbareshmëri nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm për shkak se të njëjta nuk janë pranuar nga debitori, për faktin se nga shkresat e lëndës vërtetohet se në këtë çështje juridike përmbareshmëri përmbareshmëri është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës dhe atë në bazë të faturës nr. SIT-19/21 të datës 04.05.2021 dhe faturës nr.SIT-20/21 të datës 04.05.2021, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 32,133.90 €, të cilat janë paraqitur në origjinal dhe nuk mund te vërtetohet se janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit.

Me dispozitën e nenit 29 paragrafi 1, pika 1.1. dhe 1.3 të LPP-së, shprehimisht është paraparë: *“Përmbareshmëri me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; dhe 1.3. faturat”*. Ndërsa me dispozitën e nenit 37 të LPP-së, përcaktohet se: *“Kur propozimi për përmbareshmëri paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Sipas kësaj gjykate, faturat e pranuar përbejnë dokumente të besueshme të përshtatshme për përmbareshmëri dhe në këtë rast paraqesin bazë për lejimin e përmbareshmërit në kuptim të dispozitave ligjore të sipërcituara, përderisa mënyra e pranimit bëhet në formë të dëshmisë zyrtare qoftë me nënshkrim apo vulë, përderisa të mos provohet se një gjë e tillë është keqpërdorur nga ndonjë nga

subjektet. Andaj, tani për tani Dhomat e Shkallës së Dytë nuk mund të vijnë deri te një konkludim se të njëjtat janë të papranuara apo se rregullsia e pranimit nga ana e debitorit nuk ka qenë e ligjshme.

Gjykata e shkallës së dytë duke i pranuar si të themelta pretendimin ankimore në këtë drejtim, çështjen vendosi t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vlerësojë edhe njëherë pretendimet e palëve, në veçanti pretendimet e debitorit në prapësim, respektivisht të vlerësojë se a janë plotësuar kushtet për lejimin e përmbarimit sipas dokumenteve të besueshme – faturave të cilat debitori i ka nënshkruar, e më pastaj ka mundësi që të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në veçanti gjykata e shkallës së parë ka për detyrë të përcaktojë nëse faturat në mënyrën se si janë lëshuar, a i plotësojnë kushtet e përmbarueshmërisë sipas dispozitave të LPP-së.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209 pika d) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.669/2023, me datë 01.03.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami